



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN**

ZYRA E KRYETARIT

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORATEVE PËR VITIN 2018

Lipjan, Janar 2018

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

Objektivat -2018

-Efikasiteti i punës në administratën komunale, shërbime elektronike dhe lehtësishtë të çasëshme në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve si dhe ofrim të shërbimeve cilësore për qytetarët dhe zvogëlimi i shpenzimeve.

-Investimi në infrastrukturën shkollore dhe rritja e efektshmërisë qeverisëse të shkollave dhe rritja e cilësisë në arsim, sigurimi i kabineteve të shkencave të natyrës për disa shkolla, fuqizimi i të gjitha organeve profesionale të shkollave si këshillat e prindërve dhe këshillat drejtuese si dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e arsimit, përgatitja dhe miratimi i rregullores në Kuvendin Komunal për kodin e mirësjelljes së nxënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme të ulëta si dhe shkallë të lartë të respektimit të ligjshmërisë në sferën e arsimit, Shtimi i linjave të transportit për nxënës të siguruar nga Komuna edhe për disa relacione, Funksionalizimi i bibliotekave shkollore në disa shkolla të Komunës.

-Zhvillimi dhe mbrojtja e vlerave të kulturës, mbështetja e aktiviteteve rinore dhe sportive si dhe ndërtimi i infrastrukturës fizike. Kijimi i një monografie për Lipjanin në kohra të ndryshme, organizimi i aksioneve të ndryshme rinore për mbrojtjen e ambientit, Hartimi i Strategjisë së përbashkët për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe afirmimin e vlerave turistike të komunës sonë, mbështetja e drejtëpërdrejtë dhe investive në turizëm me qëllim të promovimit të vlerave turistike dhe kulturore të komunës sonë.

-Të sigurohet një pozitë e fortë dhe e qëndrueshme financiare. Të sigurohet një planifikim fiskal, financiar dhe I shëndoshë, të ofrohen analiza dhe koordinim në mbështetje të politikës së Komunës. Të zhvillohet edhe më tutje dhe të administrohet një menaxhim financiar efektiv përmes të cilit Drejtoratet dhe të gjithë zyrtarët autorizues të kenë mundësinë të administrojnë buxhetin e tyre siç duhet dhe me përgjegjësi. Të vazhdohet me menaxhim transparent të buxhetit komunal. Në webfaqen e Komunës të publikohen të gjitha raportet nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa si dhe subvencionet. Rritja e buxhetit komunal, rishikimi i rregullativës së brendëshme lidhur me qëndrueshmërinë dhe inkasimin e të hyrave vetanake, rritja e investimeve kapitale dhe racionalizimi i shpenzimeve administrative.

-Rritja e zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit përmes rishikimit dhe lehtësimit të procedurave administrative me theks të veçantë procedurat e dhënjes së lejeve dhe pëlqimeve. Formimi i një ekipe profesionale që do të hulumtoj dhe komunikoj thirrjet për grante, donacione dhe burime tjera të financimit, Zhvillimi i Politikave dhe Dokumenteve Strategjike gjatë vitit 2018. Hartimi i “Strategjinë për Zhvillim Ekonomik 2018-2022”, vazhdimi i angazhimeve rreth gjetjes së burimeve të financimit për ndërtimin e Zonës Ekonomike “Parku Industrial në Qylagë”, -vendosja e kontakteve dhe raporteve bashkëpunuese me donatorët dhe Ambasadat e huaja rreth angazhimit të përbashkët për rritjen e Zhvillimit Ekonomik në Lipjan.

-Kontrollimi dhe mbikqyrja e kushteve të sigurisë së ushqimit për konsumatorë si dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve në bazë të ligjeve në fuqi. -Kujdes të veçantë do ti kushtohet ndërtimeve në gjithë territorin e Komunës së Lipjanit.

-Disiplinë në pastërti dhe estetikë brenda dhe jashtë objekteve të QPS, QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve dhe Shtëpinë e Komunitetit, riorganizim i shërbimeve në QKMF, -Vizita sistematike mjekësore nëpër shkolla, mbajta e ditëve botërore të shëndetësisë dhe ofrimi i shërbimeve nga QPS.

-Planifikimi hapësinor për një zhvillim të balancuar dhe funksional për tërë territorin e komunës, hartimi dhe rishikimi i planeve urbane dhe përcaktimi i kushteve urbane-teknike për tërë zonat banimore të komunës së Lipjanit, Hartimi i Hartave Zonale, Sensibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit.

-Vazhdimi i digjitalizimit të shërbimeve të gjeodezisë dhe lidhja e drejtpërdrejtë me sistemin e të dhënave me Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK), përkatësisht bartja e të dhënave grafike nga Zyra Komunale Kadastrale (ZKK) në Lipjan dhe lidhja e drejtpërdrejtë me AKK në Prishtinë, vazhdimi i azhurnimit në softverin e avancuar për azhurnimin e të dhënave grafike “CAD MAP”,

-Mirëmbajtja dhe ndërtimi i infrastrukturës publike për ofrimin e shërbimeve publike me kualitative me përkushtimin e vazhdueshëm për investime në projekte që kanë të bëjnë me mbrojtje të mjedisit dhe furnizimin

me ujë. Ndërtimi i infrastrukturës fizike duke shtuar përgjegjësinë në projektim deri në implementimin e projekteve, mirëmbajtja dhe menagjimi i projekteve të investimeve kapitale, menagjim efektiv të pasurisë dhe aseteve komunale.

-Prokurim transparent, realizimi në përpikshmëri i aktiviteteve të prokurimit të parapara sipas Planifikimit të Prokurimit për vitin fiskal 2018.

-Mbështetje e drejtpërdrejtë e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë duke e ngritur fondin për subvencione në mënyrë të vazhdueshme nga viti në vit, rritja e ruajtja e sipërfaqëve me pyje, hulumtimi i donacioneve me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme në lëmin e bujqësisë.

-Hartimi i Planit “Vlerësimi i rrezikut për Komunën e Lipjanit” dhe aprovimi nga KD dhe KK si dokument zyrtar, Hartimi i dokumenteve të Planit për Mbrojtje dhe shpëtim sipas ligjit dhe në bazë të Vlerësimit.

-Fuqizimi i rolit qytetarë dhe shoqrisë civile në proceset e vendimarrjes si dhe bashkpunim të vazhdueshëm me palet e interesuara në të gjitha proceset e qeverisjes lokale, bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Drejtoria i Administratës

Drejtoria për Administratë gjatë vitit 2018 do të realizojë këto objektiva:

- Efikasiteti i punës në administratë,**
- Ofrimi i shërbimeve cilësore,**
- Administratë digjitale,**
- Vendosja e GPS në veturat zyrtare,**
- Transparencë dhe llogaridhënie,**
- Zvoglimi i shpenzimeve,**
- Mbrojtja e pa kompromis e të drejtave të qytetarëve,**
- Krijimi i kushteve sa më të mira për punëtorët,**
- Krijimi i sitemit të integruar të menjimit të radhës,**
- Ofrimi i shërbimeve elektronike dhe lehtësishtë të qasëshme.**

Drejtoria i Arsimit

Objektivat me prioritet për vitin 2018:

- Sigurimi i kabineteve të shkencave të natyrës për disa shkolla fillore dhe të mesme,**
- Fuqizimi i të gjitha organeve profesionale të shkollave si këshillat e prindërve & këshillat drejtuese si dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e arsimit dhe arsimimit të përgjithshëm,**
- Përgatitja dhe miratimi i rregullores në Kuvendin Komunal për kodin e mirësjelljes së nxënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme të ulëta si dhe shkallë të lartë të respektimit të ligjshmërisë në sferën e arsimit,**
- Informimi i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo-arsimor në tërësi për gjithë territorin e komunës,**
- Angazhimi në sistemimin e nxënësve me nevoja të veçanta nëpër klasa të bashkangjitura si dhe sigurimi i mësuesve mbështetës për ta,**
- Sigurimi i stafit dhe lokacionit për fillimin e punës së shkollës së mesme të ulet të muzikës,**
- Shtimi i linjave të transportit për nxënës të siguruar nga Komuna edhe për disa relacione,**
- Organizimi i mësimi shtesë për lëndët prioritare si dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasat e mbingarkuara,**
- Krijimi i kushteve për organizimin e mësimi në një ndërrim më së paku edhe dy shkolla,**
- Funksionalizimi i bibliotekave shkollore në disa shkolla të Komunës.**

Drejtoreti për Kulturë, Rini dhe Sport

- Organizimi i nje programi kulturor, me rastin e Shpalljes së Pavarsisë së Kosovës,**
- Organizimi për poezi, prozë dhe recitatorëve në komunën tonë**
- Manifestimi kulturoro shkencorë “Gjurmë të Gjeqovit”**
- Riorganizimi i Ansamblit të këngve dhe valleve “Lipjani”**
- Riorganizimi i grupit letrar “Fazli Grajqevci” Funksionalizimi i Qendrave Rinore nëper fshatra,**
- Kijimi i një monografije për Lipjanin në kohra të ndryshme,**
- Krijimi i një muzeu për Lipjanin,**
- Organizimi i aksioneve të ndryshme rinore për mbrojtjen e ambientit,**
- Mbrëmje rinore për festa Kombëtare dhe Shtetore,**
- Organizimi i trajnimeve me të rinjtë,**
- Organizimi i kampeve verore me sportiest,**
- Krijimi i kushteve të barabarta, për të gjitha komunitetet, që jetojnë në komunën tonë në lëminë e sportit,**
- Hartimi i strategjisë së përbashkët për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe afirmimin e vlerave turistike të komunës sonë,**
- Riaktivizimi i bibliotekës në Dobrajë të Madhe, Janjevë dhe bashkpunimi me bibliotekat shkollore.**
- Krijimi i kushteve më të mira, për ruajtjen e materialit arkivor.**

Drejtoreti për Buxhet dhe Financa

- Të sigurohet një pozitë e fortë dhe e qëndrueshme financiare e Komunes së Lipjanit.**
- Të sigurohet një planifikimit fiskal dhe financiar i shëndoshë, këshilla, të ofrohen analiza dhe koordinimin në mbështetje të politikës së Komunes dhe në mbështetje të një vendimmarrje të informuar.**
- Të zhvillohet edhe më tutje dhe të administrohet një menaxhim financiar efektiv përmes të cilit drejtoratet dhe të gjithë zyrtarët autorizues të kenë mundësinë të administrojnë buxhetin e tyre siç duhet dhe me përgjegjësi.**
- Vazhdimi i menaxhimit transparent të buxhetit komunal. Në webfaqen e Komunes të publikohen të gjitha raportet nga drejtoreti për Buxhet dhe Financa si dhe subvencionet.**
- Realizimi i të hyrave vetanake në vlerë prej 1,936,600.00€ në vitin 2018. Vazhdim i rritjes së inkasmit të tatimit në pronë duke vazhduar me qasjen “zero tolerancë ndaj mospagesës së tatimit në pronë” dhe “qasjes të njejtë për të gjithë”. Të sigurohet rianketimi i 1/3 së pronave. Të vazhdohet me kontaktimin e borxhëlinjëve, procedimin e vërejtjeve dhe bllokimin e llogarive bankare mbas përfundimit të afatit për falje të borxheve. Të vazhdohet me rritjen e të hyrave nga lejet ndërtimore.**
- Vazhdimi i shlyerjes së obligimeve kontraktuale dhe financiare të gjeneruara nga vitet paraprake dhe planifikimi i shlyerjes së këtyre obligimeve në vitin e ardhshëm buxhetor përmes rritjes së të hyrave.**
- Regjistrimi i të gjitha pasurive komunale dhe pasurive në vijim.**

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim

Gjatë këtij viti, objektivi i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim është intensifikimi i angazhimeve për ndërtimin e infrastrukturës dhe promovimin e Komunës së Lipjanit si një komunë atraktive për të bërë biznes dhe për tu vizituar:

- Formimi i një ekipe profesionale që do të hulumtoj dhe komunikoj thirrjet për grante, donacione dhe burime tjera të financimit,**
- Ekipi do të hulumtoj për investitorë të jashtëm potencial dhe do të analizoj strategjitë e investitorëve të jashtëm për zgjerim në Evropën Juglindore,**
- Zhvillimi i Politikave dhe Dokumenteve Strategjike gjatë vitit 2018, hartimi i “Strategjinë për Zhvillim Ekonomik 2018-2022”,**
- Vazhdimi i angazhimeve rreth gjetjes së burimeve të financimit për ndërtimin e Zonës Ekonomike “Parku Industrial në Qylagë”**
- Zhvillimi i dokumenteve dhe materialeve të marketingut me qëllim të tërheqjes së investitorëve të jashtëm dhe vendor si dhe tërheqjen e turistëve në destinacionet turistike të Komunës së Lipjanit.**
- Vendosja e kontakteve dhe raporteve bashkëpunuese me Donatorët dhe Ambasadat e huaja rreth angazhimit të përbashkët për rritjen e Zhvillimit Ekonomik në Lipjan,**
- Promovimi i Ofertes Investive dhe vendosja e materialeve promovuese në Aeroportin e Prishtinës, hapësirat e Komunës, diskutim me Ambasadat e huaja në Kosovë për vendosjen e materialeve fizike për promovim të Zhvillimit Ekonomik në hapësirat e tyre, Ambasadave të Kosovës në vendet e jashtme, në hapësirat e Odës Ekonomike të Kosovës, Odës Amerikane, Odës Ekonomike Gjermane, diskutim rreth mundësisë së vendosjes së materialeve fizike për promovim të Zhvillimit Ekonomik në hapësirat e USAID,**

EU Office, GIZ, UNDP, OSCE, JICA, TIKA World Bank, EBRD, etj,

-Promovimi i Turizimit,

-Zhvillimi i Platformës Elektronike e cila do të ketë për qëllim informimin me kohë të Sektorit Privat, shoqërisë civile dhe grupet tjera të interesit rreth burimeve të financimit,

-Rritja e zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit përmes rishikimit dhe lehtësimit të procedurave administrative me theks të veçantë procedurat e dhënjes së lejeve dhe pëlqimeve,

-Rritja e bashkëpunimit institucional në mes të Komunës së Lipjanit dhe Sektorit Privat dhe përfshirja e Sektorit Private në vendimmarrje,

-Bashkëpunim i ngushtë me Ministritë dhe Organizatat tjera relevante,

-Menaxhimi i hartimit të aplikacioneve për projektet e dorezuara të donatorët,

-Menaxhimi dhe mbajtja e evidencës për pronën,

-Organizimi i Konferencës së Donatorëve dhe Organizimi i Konferencës së Investitorëve

-Fokusimi në inovacione,

-Smart City/Përgjegjësia ndaj ambientit dhe përgjegjësia sociale (CSR),

-Vazhdimi i menaxhimit transparent,

Drejtoria i Inspektoriatit

Drejtoria i Inspektoriatit do t'i kushtoj rëndësi të veçantë realizimit të këtyre objektivave:

- Kontrollimi dhe mbikqyrja e kushteve të sigurisë së ushqimit për konsumatorë si dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve në bazë të ligjeve në fuqi.**
- Objektiv tjetër me rëndësi të veçantë do të jetë inspektimi i lojrave të fatit.**
- Kujdes të veçantë do t'i kushtohet ndërtimit në gjithë territorin e Lipjanit.**
- Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet çështjes së ambientit, kryesisht ndotjes së ujit, tokës dhe ajrit.**
- Inspektoria do të kushtojë rëndësi edhe kontrollit të Mjeteve transportuese të udhëtarëve.**
- Kontrolla të vazhdueshme gjatë tërë vitit të barantoreve, duke përfshirë edhe ato bujqësore.**
- Mbrojtja e Planit Urbanistik të Qytetit.**
- Identifikimin e bizneseve të reja të cilat operojnë në komunën e Lipjanit që të regjistrohen në MTI si dhe pranimi teknik i tyre.**
- Inspektimi i prodhuesve ushqimorë si furrave të bukës si dhe prodhuesve të produkteve të qumështit.**

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

- Respektimi i orarit të punës QKMF, QMF dhe AMF, QPS dhe Shtëpinë e Komunitetit,**
- Disiplinë në pastërti dhe estetikë brenda dhe jashtë objekteve të QPS, QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve dhe Shtëpinë e Komunitetit,**
- Vendosja e Komunikimit të rregullt me qytetarin,**
- Investime Kapitale,**
- Riorganizim i shërbimeve në QKMF,**
- Vendosja e rregullit regional në mënyrë që të funksionalizohen edhe QMF-të dhe AMF-të,**
- Sistemi i Informimit dhe komunikimit brenda QKMF-së dhe në mes të kësaj dhe QMF-ve dhe AMF-ve,**
- Furnizimi, shpërndarja dhe kontroll në shpërndarjen e barnave,**
- Furnizimi i rregullt dhe me prioritet me barna i Shërbimit të Urgjencës,**
- Planifikimi dhe ndërhyrje me investime shtesë nga buxheti i komunës në kuptim të furnizimit me barna jashtë listës esenciale (me rishikim të buxhetit),**
- Vizita sistematike mjekësore nëpër shkolla, mbajta e ditëve botërore të shëndetësisë dhe ofrimi i shërbimeve nga QPS,**
- Vazhdimi i vizitave në shtëpi për nënën dhe fëmijën deri në 3 vjeç (vizita të karakterit këshillues),**
- Rregullimi i orarit të kujdestarisë të barnatoreve private me obligimin që orari i përgjithshëm të vendoset në derën e secilës barnatore,**
- Rishikimi dhe harmonizimi i statutit të QKMF me legjislacionin në fuqi,**

Drejtora ti për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

- Ngritja e kapaciteteve me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit,**
- Hartimi i dokumenteve planore dhe dokumentacionit tekniko projektues për projektet e planifikuara për vitin 2018,**
- Krijimi i kushteve të infrastrukturës teknike në zonat urbane dhe rurale të Komunës,**
- Ngritja e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies në cilësinë e shërbimeve,**
- Senzibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit,**
- Implementimi i Planit Urban në Komunën e Lipjanit, Mbikqyrja dhe monitorimi i zbatimit të Planit Zhvillimor,**

Drejtoreti për Gjeodezi dhe Kadaster

- Vazhdimi i digjitalizimit të shërbimeve të gjeodezisë dhe lidhja e drejtpërdrejtë me sistemin e të dhënave me Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK), përkatësishtë bartja e të dhënave grafike nga Zyra Komunale Kadastrale (ZKK) në Lipjan dhe lidhja e drejtpërdrejtë me AKK në Prishtinë,**
- Vazhdimi i azhurimit në softverin e avancuar për azhurnimin e të dhënave grafike “CAD MAP”,**
- Presim skanimin e të gjitha lëndëve pas vitit 1999 e deri me 2014, si të pjesës tekstuale ashtu edhe të pjesës grafike (skicave të ndryshme) të para vitit 1999, skanimi i regjistrave të terrenit dhe regjistrave të kadastrit.**
- Pjesëmarrja në vazhdimësi në trajnime, aftësime profesionale dhe avancime tjera.**
- Ngritja profesionale dhe rritja e të hyrave në Drejtoreti.**
- Presim nga Agjencia Kadastrale e Kosoves që në suazë të projekteve që ka për rindërtimin e zonave Kadastrale ta ketë konsideratë Komunën e Lipjanit që ta fus në projekt ndonjë zonë Kadastrale në Rindërtim.**

Drejtoria i Shërbimeve Publike

- Mbikëqyrja e kompanive: kompaninë për pastrimin e rrugëve, kompaninë për menaxhimin e mbeturinave, kompaninë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, kompaninë për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe kanalizimit fekal, mbikëqyrja e kompanis së mirëmbajtjes së tregjeve, mbikëqyrja e kompanisë për sinjalizimin vertikal dhe horizontal dhe mbikëqyrja e kompanisë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale,**
- Inicimi i procedurave për realizimin e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2017,**
- Mbikëqyrja dhe menaxhimi gjatë realizimit të projekteve për investimet kapitale,**
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrinë e Pushtetit Lokal, Departamentet për Shërbime Publike të Komunave tjera, Drejtorinë e Rrugëve të Kosovës dhe zbatimi i Ligjeve të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës dhe instruksionet e aprovuara nga Ministrinë përkatëse që kanë të bëjnë me Shërbime Publike,**
- Bashkëpunimi me ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike (Aeroportin, PTK-në, KEDS-in, PTK-në, Ndërmarrjet Regjionale të Ujësjetës dhe Menaxhimit të Mbeturinave, Ndërmarrjet Private të Transportit të udhëtarëve, Ndërmarrjet tjera që do të kryejnë shërbime publike në Komunën e Lipjanit).**

Drejtoria e Prokurimit

Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Prokurimit ka Planifikuar:

- Prokurim transparent,**
- Realizimi në përpikmëri i aktiviteteve të prokurimit të parapara sipas Planifikimit të Prokurimit për Vitin Fiskal 2018,**
- Kërkesë për njësitë kërkuese për rrespektimin e Planifikimit të Prokurimit,**
- Planifikimi dhe përfundimi me kohë i çdo projekti,**
- Funksionalizimi i databazës për blerje të imta,**
- Implementimi i kontratave afatgjata,**
- Kryerja me afat të të gjitha punëve sipas planit të prokurimit,**
- Bashkëpunimi me Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe subjekte të tjera.**

Drejtoreti për Bujqësi dhe Pylltari

- Vazhdimi i stimulimit të zhvillimit të bujqësisë dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese,**
- Modernizimi i bujqësisë, përmes tërheqjes së investimeve,**
- Përgatitja, prezantimi, kërkesa dhe zbatimi i projekteve të ndryshme,**
- Punësimin dhe mirëqenien ekonomike të fermerëve përmes: Subvencioneve për fermerë, Shërbimeve Këshillimore,**
- Komunikim dhe kshillim i vazhdueshëm me fermerë,**
- Rritja e ruajtja e sipërfaqëve me pyje,**
- Hulumtimi i donacioneve me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme në lëmin e bujqësisë**
- Bashkëpunimi i ngushtë me MBPZHR, fakultetin e bujqësisë, OJQ-të si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkomunal,**
- Ruajtja dhe kultivimi i Florës dhe Faunës,**
- Aktivizimi i sistemit të ujitjes.**

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Gjatë vitit 2018 Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim prioritet do të ketë:

- Ndihmë për nevojat emergjente,**
- Ndërhyrje emergjente në parandalimin e vërshimeve në zonat kritike,**
- Ndihmë emergjente për banorët e rrezikuar,**
- Intervenim me kohë dhe të shpejtë në raste të zjarreve të ndryshme,**
- Krijimi i një baze të të dhënave për subjektet afariste nga lëmia e ndërtimit të etj të cilat mund të angazhohen në tejkalimin e ndonjë emergjence madhore,**
- Hartimi i Planit "Vlerësimi i rrezikut për komunën e Lipjanit" dhe aprovimi nga KD dhe KK si dokument zyrtar,**
- Hartimi i dokumenteve të Planit për Mbrojtje dhe shpëtim sipas ligjit dhe në bazë të Vlerësimit,**
- Azhurnimi i regjistrave të personelit të shtabeve lokale për reagim emergjent në raste të zjarreve apo fatkeqësive tjera,**
- Angazhimi i forcave shtesë për fikjen e zjarreve sezonale,**
- Inicimi i themelimit dhe mirëmbajtjes së një "Fondi emergjent" për përdorim në rrethana emergjencash dhe situatash të jashtëzakonshme.**